



DEPARTAMENTI I MJEKËSIS LIGJORE
EULEX – KOSOVË

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE TË DML-së SË EULEX-it
OPERACIONET E NJËSISË PËR PËRSONA TË ZHDUKUR

PERIUDHA E RAPORTIMIT: 09 Dhjetor 2009 – 08 Dhjetor. 2010 (2011 DML-010)

Hyrje

Në këtë raport paraqiten rezultatet e aktiviteteve që ka ndërmarrë EULEX-i dhe DML-ja si pjesë e operacioneve për persona të zhdukur gjatë periudhës nga 9 dhjetori 2009 deri me 08 dhjetor 2010. Raporti ndahet në këta kapituj:

- Kapitulli 1 – Mandati i EULEX/DML
- Kapitulli 2 – Rezultatet nga operacionet fushore
- Kapitulli 3 – Rezultatet antropologjike të EULEX-it
- Kapitulli 4 – Mbetjet e pidentifikuar
- Kapitulli 5 – Udhëzimi i identifikimeve të gabueshme
- Kapitulli 6 - Bashkimi i eshtrave me trupa të pajetë në mënyrë të gabuar
- Kapitulli 7 – Hetimet arkivore
- Kapitulli 8 – Dorëzimi i mbetjeve mortore tek familjet përkatëse
- Kapitulli 9 – Shoqëria civile
- Kapitulli 10 – Plani i punës 2011

PËRBMLEDHJE E SHKURTËR

Në vitin 2010 EULEX-i si dhe Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) kanë zhvilluar 101 operacione fushore dhe ka gjetur 34 individë. Janë gjetur dhe identifikuar pesëdhjetë e shtatë (57) persona të zhdukur. Familjeve përkatëse u janë kthyer 103 mbetje. Tani po zhvillohet një analizë në detale për mbetjet e pidentifikuara. Janë shqyrtuar mbi 700 dosje që kanë të bëjnë me raste të përziera, copëtuara dhe djegura. 580 mostra eshtrash janë zgjedhur për analizën e ADN-së dhe si rrjedhim janë bërë 231 ribashkime të eshtrave.

Për vitin 2011, janë identifikuar mbi 20 raste me lokacione potenciale për operacione fushore. Këtu përfshihen lokacione të mëdha e të vogla si varrezat, minierat, një pus, një ish-poligon i madh për gjuajtje me armë etj. Përveç kësaj, do të vazhdoj puna intensive në mbetjet e pidentifikuara. Do të zhvillohen aktivitete intensive të informimit.

Sfidat më të mëdha për vitin 2011 janë: gjetja e informatave të besueshme që shpien në varrezat e mundshme, përcaktimi i identitetit të mbetjeve që mbahen në DML dhe bashkëpunimi me familjet dhe i Shoqatat e Familjeve.

KAPITULLI 1 – MANDATI I EULEX/DML

EULEX-i është Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, i themeluar me 4 shkurt 2008 me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP. Misioni u miratua nga Qeveria e Kosovës dhe 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, me mandatin që t'i ndihmoj organet gjyqësore të Kosovës dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë. Ky mision filloi së funksionuari me 9 dhjetor të vitit 2008.

Në qershor të vitit 2010, në pajtim me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-137 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ZPZHML u shndërrua në "Departament të Mjekësisë Ligjore" nën Ministrin e Drejtësisë së Kosovës. DML ishte themeluar "si organ publik kompetent përgjegjës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore dhe hetime mjekësore mbi vdekjen, duke përfshirë zhvarrosjen e mbetjeve mortore nga konflikti në Kosovë dhe kthimin e mbetjeve mortore familjet përkatëse".

Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) është institucion shkencor i Ministrisë së Drejtësisë me specializim në një fushë të gjerë mjeko-ligjore. Objektivat kryesore të tij janë:

- Zbardhja e fatit të personave të zhdukur si pasojë e konfliktit në Kosovë dhe pas tij,
- Forcimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë duke dhënë dëshmi fizike shkencërisht të shëndosha që mund të japin ndihmë në kërkim të drejtësisë,
- Të jetë mu në ballë të zhvillimeve që lidhen me mjekësinë ligjore në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit.

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it punojnë përkrah me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë në DML për të ndihmuar në kërkimin e personave të zhdukur dhe për të zhvilluar një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv të mjekësisë ligjore. Prej 9 dhjetorit 2008, EULEX-i ka marr funksionet monitoruese, udhëheqëse, këshilluese dhe ekzekutive në kuadër të DML. Për ta përbushur mandatin e tyre, ekspertët e EULEX-it punojnë në bashkëpunim të plotë me partneret e tyre nga DML në Ministrinë e Drejtësisë.

DML ka këtë mandat të dyfishtë:

- 1) Të zbardhë fatin e personave të zhdukur:
 - Të vlerësojë dhe rihap varrezat e dyshuara
 - Të kryej autopsitë e mbetjeve të paidentifikuara për të përcaktuar shkakun e vdekjes kur kjo gjë është e mundur dhe të kryej identifikimin në mënyrë profesionale duke përdorur analizën e ADN-së kur është e nevojshme.
 - T'i informojë në vazhdimësi familjet e personave të zhdukur mbi progresin e arritur dhe t'ua kthej familjeve mbetjet e identifikuara mortore në kohë të duhur dhe mënyrë të respektuar,
 - T'i azhurnojë shënimet dhe statistikat mbi personat e zhdukur në Kosovë.
- 2) Të sigurojë një sistem mjeko-ligjor në Kosovë me standarde evropiane, duke përfshirë këto specializime, por jo enkas të kufizuar në to:
 - Ekzaminimin mjekësor të viktimave nga veprat fizike/seksuale,
 - Autopsitë në raste të vdekjeve të dyshuara jonatyrale,
 - Raste nga praktika e gabueshme mjekësore,
 - Analiza toksikologjike,
 - Analiza histopatologjike,

- Analiza mjeko-ligjore ne vende të ngjarjeve.

DML ka krijuar një sistem koherent të procedurave të punës dhe protokolleve mbi zhvarrimet, autopsitë, identifikimin, kthimin e mbetjeve dhe përgatitjeve për varrim, gjë që respekton kushtet e sistemit gjyqësor dhe nevojat e familjeve.

Zgjedhja e fatit të personave të zhdukur në Kosovë është një detyrë që ka rrugë tepër të gjatë dhe komplekse të cilën e rëndon në veçanti konteksti shoqëror dhe politik. Përmes revizionit sistematik të shënimeve, mbylljes së rasteve të personave që nuk janë më të zhdukur, kontrollimit të vazhdueshëm dhe rihapjes së varrezave, identifikimin dhe kthimin e mbetjeve, numri i personave të zhdukur është zvogëluar nga 5236 (të dhëna nga qershori 2002) në 1821 (të dhëna zyrtare në dhjetor të vitit 2010). Kjo do të thotë se 3415 (65%) të rasteve janë sqaruar brenda 8 vitesh.

1.1 RREGULLORJA E EULEX/DML LIDHUR ME ÇËSHTJEN E TË ZHDUKURVE

Për EULEX-in dhe DML-në hetimi dhe zgjedhja e çështjes së të zhdukurve nga konflikti në Kosovë dhe në periudhën pas tij ka përparësi kryesore. Problemet e vështira që shoqërojnë rastet e personave të zhdukur kërkojnë një përgjigje të shpejtë, unike dhe të vazhdueshme. Hetimet, bashkë me aktivitetet informuese janë dhe do të jenë në kohë të duhur dhe të kuptimshme.

Ndërkaq që mbi 65% të zhdukurve janë gjetur, që prej datës së lëshimit të këtij dokumenti, në Kosovë mbasin akoma 1821 raste të pasqaruara. Hetimet zakonisht ballafaqohen me raste që kryesisht u mungon drejtimi i hetimeve. Problemet e natyrës hetuese ngatërrohen me kalimin e kohës: shumica e zhdukjeve kanë ndodhur që prej një dekade. Ndërlikimet gjatë hetimeve e shtojnë nevojën për përfshirje dhe bashkëveprim aktiv me sektorë relevant të shoqërisë civile në përpjekje për të krijuar shtigje të reja për zhvillimin e hetimeve.

Politikë e EULEX/DML-së është të siguroj se:

- Të gjitha raportet hetohen plotësisht,
- Të krijohet një dosje complete e rastit dhe të azhurohet kur sigurohen informate të reja
- Të përdoret çdo mjet i nevojshëm në dispozicion të DML-së për të ndihmuar në zhvillimin e hetimit,
- Të bëhet çdo koordinim relevant me departamente tjera dhe njësitë relevante,
- Familjet e personave të zhdukur të informohen në vazhdimësi lidhur me zhvillimin e hetimeve. Të ndërmerren të gjitha përpjekjet për të risiguar familjet së po përdoren metoda hetuese dhe mjeko-ligjore,
- Tu mundësohet qasja ne informim familjeve dhe Shoqatave te Familjeve,
- Të mbahen raporte adekuate dhe të sakta me media në lidhje me të zhdukurit dhe mbetjet e paidentifikuara mortore,
- Të mos mbyllet asnjë rast derisa të zgjidhet fati i personave të zhdukur.

KAPITULLI 2 – REZULTATET NGA OPERACIONET NË TERREN

DML-ja ka ndërmarr një fushatë intensive ne terren që ka rezultuar me 101 operacione në terren duke gjetur 34 individë. Mbi 20 vende të reja të varrezave të mundshme janë identifikuar për hetime të mëtejme në vitin 2011.

Bashkëpunimi i shumë Shoqatave të Familjeve ka luajtur një rol vendimtar në arritjen e rezultateve deri tani, veçanërisht në rastet e dyshuara të identifikimit të gabueshëm nga viti 1999. Harta në vijim dhe tabelat 1 dhe 2 tregojnë shpërndarjen gjeografike të operacioneve në terren:

Harta 1 – Numri i operacioneve fushore dhe i individëve të gjetur sipas regjioneve.




Tabela 1: Operacionet fushore sipas regjionit

Rajoni	Operacioni fushor	Individë të gjetur
Mitrovica	20	13
Prishtina	25	9
Gjilan	4	1
Peja	2	2
Prizren	28	2
Ferizaj	5	1
Gjakova	10	6
Gjithsej	94	34

Tabela 2: Operacionet fushore sipas komunave

Komuna	Operacioni fushor	Individë të gjetur
Deçan	3	0
Gjakova	4	6
Ferizaj	3	1
Gjilan	1	1
Drenas	0	0
Istog	0	0
Kaçanik	2	0
Kamenica	1	0
Klina	0	0
Lipjan	3	2
Malisheva	0	0
Mitrovica	4	1
Podujeva	7	2
Peje	2	2
Prizren	19	1
Prishtina	15	5
Rahovec	3	0
Skenderaj	1	1
Suhareka	9	1
Viti	2	0
Vushtri	14	11
Zubin Potok	1	0
Gjithsej	94	34

2.1 VENDET E DYSHUARA JASHTË KOSOVËS

Përfaqësuesit e EULEX-it dhe DML-së kanë marrë pjesë si i vëzhgues këto vlerësimin e këtyre vendeve në Serbi:

Tabela 3: Vendet e vizituara si vëzhgues

Vende të pohuara	Data	Statusi
Medvegja	29 prill	Në pritje
Rudnice	25 qershor	Negativ
Rudnice	08 korrik	Negativ
Perucac	09 gusht	Negativ
Rudnice	22 shtator	Negativ

EULEX-i do të vazhdoj të kërkoj nga autoritetet serbe që t'i kontrollojë lokacionet e mundshme si psh., në Rudnice, në mënyrë shkencore dhe sistematike duke përdorur metodologjitë dhe teknikat adekuatë.

EULEX-i dhe autoritete malazeze bashkërisht kanë zhgroposur një lokacion të supozuar në qytetin Andirjevac prej datës 19 deri me 27 korrik. Rezultati ishte negativ.

Janë bërë kontakte me autoritetet e Maqedonisë dhe të Shqipërisë lidhur me varrezat e mundshme në territoret e tyre.

KAPITULLI 3- REZULTATET E ANTROPOLOGJISË MJEKO-LIGJORE

Si rezultat i punës identifikuese të kryer në EULEX/DML, në mënyrë pozitive janë identifikuar 103 individë në vitin 2010, 57 prej të cilëve ishin persona të zhdukur

Puna antropologjike mjeko-ligjore rezultoi në përzgjedhjen e 580 mostrave të eshtrave për analiza të mëtejme, përfshirë profilimin gjenetik të kryer nga KNPZH. Për më tepër, 231 mostra eshtrash u janë ri-bashkuar individëve tjerë.

Është kryer një analizë edhe vlerësim i hollësishëm i disa rasteve të mbetjeve të përziera dhe të djegura nga disa regjione të Kosovës. Një ushtrim identik është kryer me mijëra pjesë të fragmentuara trupore nga lokacionet e zhvarrosura në Serbi (Bajna Basta, Petrovo Selo dhe Batajnica). Kjo punë është kryer në ndërlidhje me rishqyrtimin e mbi 700 dosjeve.

KAPITULLI 4- MBETJET E PAIDENTIFIKUARA MORTORE

4.1 HYRJE

Identifikimi i trupave dhe pjesëve të trupit nën kujdesin e DML-së (Departamenti i Mjekësisë Ligjore) është i prioritetit më të lartë dhe përbën një komponentë themelore të strategjisë së DML-së. Për këtë qëllim, DML ka punuar intensivisht në rishqyrtimin e secilit rast dhe ka bërë një përparim të madh. Gjithashtu, janë dërguar mbi 580 mostra të reja eshtrash në KNPZH (Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) për analiza të AND-së. Gjatë 12 muajve të fundit, EULEX-DML ka vazhduar të punojë intensivisht në çështjen e mbetjeve mortore të paidentifikuara të cilat mbahen në morg. Kjo detyrë ka kërkuar shumë punë intensive dhe ka qenë tejet komplekse. Detyra nuk ka përfunduar pasi që kërkon analiza të mëtejshme dhe të hollësishme dhe bashkëpunim me shoqërinë civile.

4.2 NJË UDHËZUES PËR TË KUPTUAR MBETJET E PAIDENTIFIKUARA MORTORE NË DML-Rastet e Kosovës

- Janë 250 trupa.
- Janë 101 pjesë trupore.
- Janë 168 trupa meshkujsh kundrejt 82 trupave femrash. Janë 80 pjesë trupore mashkullore kundrejt 21 pjesëve trupore femërore.
- Të gjitha janë profilizuar nga KNPZH (të gjitha kanë "gjurmë gishtash" të AND-së). Megjithatë, për një numër të madh rastesh këto profile janë disa vite të vjetra. Ne sugjerojmë fuqimisht që rastet problematike të ri-profilizohen duke përdorur teknologji dhe metoda të reja të ofruara nga KNPZH ose laboratorët tjerë.
- Në vitin 2010, gjashtëmbëdhjetë (16) mostra të dërguara në vitin 2002 dhe 2003 më në fund janë përputhur me gjakun. Këto raste kanë zgjatur 7-8 vite që të bëhet përputhja.
- Për pjesën tjetër të trupave dhe pjesëve trupore, asnjëra deri tash nuk është përputhur me bazën e të dhënave të gjakut, kështu që ato mbesin të paidentifikuara.
- Nëse të afërmit nuk kanë dhënë gjak: personi i tyre i zhdukur mund të jetë në DML.
- Ne e dimë se janë më shumë se 250 mostra të pakompletuara gjaku. Janë po ashtu 61 raste për të cilat nuk ka gjak fare..
- Në total, janë 311 raste të cilat nuk mund të identifikohen sepse nuk kemi gjak për të bërë krahasimin.
- Disa nga mbetjet mortore të varrosura gjatë dhe pas konfliktit ndoshta janë IDENTIFIKUAR GABIMISHT dhe se ata mund të jenë në fakt persona të zhdukur, ndërsa mbetjet mortore në DML janë të atyre personave të cilët kurrë nuk janë raportuar si të zhdukur (Shih Kapitullin 5: Adresimi i identifikimeve të gabuara potenciale më poshtë).

Tabela 4: Sipas komunave

Komuna	Trupa	Pjesë trupore
Deçan	2	9
Gjakova	27	14
Ferizaj	3	0
Gjilan	2	1
Drenas	1	1
Istog	2	17
Kaçanik	4	1
Kamenica	2	0
Klina	3	0
Lipjan	0	1
Malisheva	3	1
Mitrovica	23	8
Podujeva	2	1
Peje	23	18
Prizren	34	7
Prishtina	82	9
Rahovec	8	2
Skenderaj	3	7
Suhareka	14	2
Vushtri	12	2
Gjithsej	250	101

Tabela 5: Sipas regjionit

Regjioni	Trupa	Pjesë trupore
Mitrovica	38	17
Prishtina	85	12
Gjilan	4	1
Peja	28	35
Prizren	51	10
Ferizaj	7	1
Gjakova	37	25
Total	250	101

Tabela 6: Lokacionet nga Serbia


Lokacioni	Profillet ADN
Banja Basta	3
Batajnica	6
Batajnica 03	6
Batajnica 05	6
Batajnica 07	5
Gjithsej	26

Tabela 6 paraqet numrin e profileve të AND-së pa përputhje nga varret masive që ndodhen në Serbi në 2001, 2002, dhe 2003. Një total prej 26 profileve unike (26 individë) mbeten për t'u identifikuar. Ata nuk janë identifikuar ende sepse nuk janë përputhur akoma me mostrat e gjakut në bazën e të dhënave të gjakut.

4.3 STRATEGJIA AKTUALE:

Sikurse gjatë vitit 2009, në vitin 2010 EULEX-DML ka bashkëpunuar me shoqatat e familjeve anembanë Kosovës për të gjetur familjet, të cilat mund të kenë dyshime lidhur me identitetin e mbetjeve mortore që ata i kanë varrosur pa mbështetje shkencore. Së pari ne po fokusohemi në ngjarjet të cilat kishin kushtet që zakonisht shpinin në keq-identifikime. Kjo strategji, megjithatë, është më e thellë se kaq: Posa të përcaktohen familjet potenciale, personeli i DML-së i afrohet për t'iu shpjeguar dhe përshkruar situatën me të gjitha detajet. Rastet zakonisht janë unike me rrethanat e tyre kështu që secili rast meriton një qasje individuale. Në shumë raste, e tëra që kërkohet është një mostër gjaku; në rastet tjera kërkohet mostra edhe e eshtrave edhe e gjakut, ndërsa në tjerat nevojitet një zhvarrosje dhe autopsi e plotë. (Shih Kapitullin 5: Adresimi i identifikimeve të gabuara potenciale më poshtë).

Harta 2- TRUPAT DHE PJESET TRUPORE SIPAS REGJIONIT



KAPITULLI 5: ADRESIMI I IDENTIFIKIMEVE TË GABUARA POTENCIALE

Korrigjimi i rasteve të identifikimeve të gabuara potenciale nga vitet 1999 dhe 2000 është një proces i gjatë që kërkon takt të konsiderueshëm për të kontaktuar me familjet, shoqatat e familjeve dhe udhëheqësve të komuniteteve, durim dhe vëmendje për detaje gjatë analizimit të dokumenteve dhe situatës në terren, përfshirë varrezat ekzistuese dhe vendet potenciale të varrimit.

Strategjia e DML-së për adresimin e identifikimeve të gabuara potenciale përfshinë këto veprime:

- Zhvarrosjen e mbetjeve mortore me kërkesë të anëtarëve të familjeve për konfirmimin e identitetit me ndihmën e testimin të AND-së.

- Analizën e ADN-së të mostrave rezervë të TNKJ-së (Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës r ish-Jugosllavinë) të mbledhura në vitin 2000
- Analiza dhe shqyrtimi i ngjarjeve specifike siç janë Pastaseli, Rezalla, Makermali, Bishtrazhini, Studime, Dubrava, etj. Mbledhja e gjakut dhe zhvarrosjet nëse nevojitet.

5.1 ZHVARROSJET E KËRKUARA NGA FAMILJET

Në vitin 2004, DML (në atë kohë ZPZhML) filloi të pranojë kërkesa nga familjet për zhvarrosjen e mbetjeve mortore të të afërmeve të supozuar të vrarë gjatë konfliktit me qëllim të konfirmimit të identitetit të tyre me anë të analizës së ADN-së. EULEX-DML është duke vazhduar këtë punë të domosdoshme. Kriteret për pranimin e kërkesave të tilla janë këto:

- Data e ngjarjes. Viktima e supozuar është vrarë gjatë konfliktit.
- Natyra e ngjarjes (pritë, pikë kontrolli, bombardimi i fshatrave, etj).
- Numri i viktimave që rezultojn nga ngjarja.
- Niveli i dekompozimit të mbetjeve mortore.
- Kush ka pohuar se i ka njohur mbetjet mortore?
- Kush i ka varrosur mbetjet mortore?
- Ka dyshim të bazuar lidhur me identitetin e trupit.
- Të përfshira janë rastet ku familjet ose fqinjët i kanë gjetur mbetjet mortore në sipërfaqe.

Që nga viti 2004, janë zhvarrosur 109 mbetje mortore me kërkesë të familjeve. Profilimi me ADN është në pritje për 5 nga këto raste, 11 nga 109 rastet e mbetura janë identifikuar gabimisht (përafërsisht 11%).

Në vitin 2010, nga gjithsej 34 trupave të zhvarrosur nga janari deri në mes të nëntorit, 12 trupa janë zhvarrosur me kërkesë të familjeve.

Tabela 7: Të dhënat e identifikimit të gabuar sipas vitit

Vitet	Totali i trupave të zhvarrosur	Trupat e zhvarrosur me kërkesë të familjes (% e rasteve të tilla krahasuar me numrin total)	Numri i identifikimeve të gabuara (% e identifikimeve të gabuara krahasuar me numrin e zhvarrosur me kërkesë të familjes)
2004	121	13 (11%)	0 (0%)
2005	112	0 (0%)	n/a
2006	59	11 (19%)	1 (9%)
2007	73	22 (30%)	2 (9%)
2008	53	16 (30%)	2 (12.5%)
2009	101	35 (35%)	3 (8.6%)
2010	34	12 (30%)	3 (n/a)
Total	553	109 (18.5%)	11 (10.6%)

Autopsia kryhet mbi të gjitha mbetjet mortore dhe mostrat e eshtrave dërgohen me identitetet e supozuara shoqëruese për testim me ADN.

Mesatarisht, DML pranon tri kërkesa në muaj dhe aktualisht ka dy kërkesa që presin zhvarrosjen.

5.2 TNKJ "MOSTRA REZERVË"

Në vitin 2000, TNKJ mblodhi mostra eshtrash për analiza të ardhshme me anë të ADN-së. Pas mbylljes së operacionit të TNKJ-së, këto mostra i janë dorëzuar UNMIK-ut. Kur ZPZhML u krijua në vitin 2002, mostrat e prera nga trupat NN u dërguan në KNPZH për analizë të ADN-së. Mostrat të cilat i përkisnin trupave

tashmë të identifikuar dhe të kthyer familjeve në vitin 2000 (të referuar këtu si “mostra rezervë”) janë ruajtur në morg.

Në vitin 2006, DML dërgoi një mostër rezervë për analizë të ADN-së me kërkesë të familjes e cila dëshironte të konfirmonte identitetin e trupit të varrosur në vitin 2000. Identiteti qe konfirmuar. Edhe dy mostra tjera rezervë u dërguan në vitin 2008, përsëri me kërkesë të familjeve. Identitetet u konfirmuan përsëri.

Në vitin 2009, DML filloi t'i dërgonte mostrat rezervë pa kërkesë të familjarëve. DML u përqendrua në dy lokacione në komunën e Skenderajt, më saktësisht në Makermal dhe Rezallë, ku DML ka dyshuar se mund të kenë ndodhur identifikime të gabuara. Nga 48 mostra rezervë eshtrash të dërguara për analiza të ADN-së, 29 janë përputhur me identitetet e supozuara, pasi që familjet u pajtuan të japin gjak. Nga këto 29 mostra, 18 rezultate konfirmuan identifikimin fillestar të bërë në vitin 2000, katër rezultate ishin negative dhe 7 janë ende në pritje. Të 19 mostrat e dërguara pa identitet të supozuar nuk janë përputhur me reference gjaku deri më sot.

Një rezultat negativ është pranuar për Makermalin. Trupi i identifikuar gabimisht është zhvarrosur dhe trupi i vërtetë i është kthyer familjes (shih paragrafin 5 më poshtë).

DML është duke vazhduar analizën e lokacionit në Rezallë dhe familjet tjera do të kontaktohen për mbledhjen e gjakut me shpresë se këto identifikime të gabuara do të korrigjohen.

Pastaj lokacionet tjera do të konsiderohen për rishqyrtim dhe analizë dhe më shumë mostra rezervë do të dërgohen për testim të ADN-së.

5.3 ANALIZA SIPAS NGJARJES – 1: PASTASELI (KOMUNA e RAHOVECIT)

Pastaseli ka qenë ngjarja e parë e përmendur në GPS (Grupi Punues i Sigurisë) në vitin 2006 si test potencial për rastet e identifikimeve të gabuara.

106 trupa janë varrosur nga familjet në vitin 1999. 96 prej këtyre trupave janë zhvarrosur nga ekipet serbe mjeko-ligjore për t'iu bërë autopsinë dhe të rivarrosen në varreza të ndryshme në komuna të ndryshme. Këto varreza pastaj janë ri-hapur ose drejtpërdrejtë nga familjen që kërkonin të afërmit e tyre të zhdukur ose nga TNKJ në vitin 1999. Pjesa më e madhe e trupave zhvarrosura janë identifikuar bazuar në rrobat, ndër këto 56 i përkisnin viktimave të ngjarjes në Pastasel. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2009, 37 trupa tjerë janë identifikuar me anë të ADN-së si viktimat të ngjarjes.

Në fillim të vitit 2010, 13 burra ende konsideroheshin të zhdukur nga ngjarja në Pastasel dhe DML kishte eshtrat e një numri minimal të 28 meshkujve të paidentifikuar (trupat dhe pjesët trupore) të zhvarrosura nga varrezat ku janë gjetur viktimat tjera nga Pastaseli (Prizren – Varreza Tusus, Varreza Shirokë/Siroko, Serbice e Poshtme, etj). Profili i gjakut të të afërmeve e 13 meshkujve nuk janë përputhur me profilet e eshtrave të mbetjeve mortore në morg. Mbetjet mortore të këtyre burrave me gjasë janë varrosur me identitet të gabuar nga familjet e tyre.

Megjithatë, pjesa më e madhe e familjeve kundërshtonin ri-zhvarrosjen e të afërmeve të tyre për autopsi të re dhe testim të ADN-së. Në fakt, asnjë familje nga Pastaseli nuk është paraqitur ndonjëherë në DML me kërkesë për ri-zhvarrosje. Alternativa më e mirë ka qenë mbledhja e mostrave të gjakut prej sa më shumë familjeve që është e mundur me qëllim të krahasimit të këtyre profileve të gjakut me profilet e trupave NN nën përkujdesjen e DML-së. Është e qartë se kjo nuk do t'i zgjidh të gjitha rastet e identifikimeve të gabuara, por vetëm ato ku mbetjet e sakta mortore qëndrojnë në morg.

Rasti i Pastaselit paraqet një sfidë të veçantë: meqë viktimat ishin varrosur në komuna të ndryshme, së bashku me viktimat nga vendet dhe ngjarjet tjera, identifikimet e gabueshme potenciale nuk janë të brendshme për ngjarjen. Mund të ketë rast të identifikimeve të gabuara që ndërthuren me ngjarjet tjera.

Në shkurt 2010, DML filloi t'i kontaktojë familjet në mënyrë sistematike. Disa familje refuzuan të japin gjak, por kontaktet e atyre që pranuan u dërguan te KNPZh. Deri më tash, referencat e gjakut janë mbledhur nga 18 familje dhe DML tashmë ka marrë rezultatet e ADN-së të cilat tregojnë identifikimet e gabuara në dy raste, pasi që profilet e gjakut të të afërmeve përputhen me profilet e eshtrave të paidentifikuara që ndodhen në DML.

- Emri nuk është dhënë (përputhje të AND-së me trupin e mëparshëm NN HP35-001B)
- Emri nuk është dhënë (përputhje të AND-së me trupin e mëparshëm YMI12-001B)
- Emri nuk është dhënë (përputhje të AND-së me trupin e mëparshëm KRO01-001B)

Mbetjet mortore të varrosura gabimisht me këto dy identitetet (që nuk janë dhënë) do të zhvarrosen në javët në vijim dhe mbetjet e vërteta mortore do t'iu dorëzohen familjeve. DML shpreson se këto dy raste do t'i inkurajojnë familjet tjera të japin gjak ose edhe të kërkojnë ri-zhvarrosjen e mbetjeve mortore të varrosura nën emrin e të afërmeve të tyre për të verifikuar identitetin me analizë të ADN-së.

5.4. ANALIZAT SIPAS NGJARJES – 2: STUDIME, KOMUNA E VUSHTRRISE

Në rastin e Varrezës së Studimes, identifikimet e gabuara në shumicën e rasteve janë të brendshme, p.sh. brenda grupit prej 96 viktimave të vrara më 2 maj 1999 por gjithashtu mund të përfshihen edhe disa viktimë të luftës në të njëjtën varrezë.

Të gjitha mbetjet mortore të pranishme në varrezë janë varrosur nga fshatarët dhe disa prej tyre janë zhvarrosur më 1999 nga TNKLJ dhe janë rivarrosur pas autopsisë në të njëjtën varrezë. Varret e dy viktimave të ngjarjes së 2 majit nuk janë gjetur dhe familjet i kanë raportuar si të zhdukur. Megjithatë, në raportet e TNKLJ është përmendur prania e disa NN trupave, e disa prej tyre kane mund të identifikohen më vonë nga familjarët e tyre.

Në vitin 2002 dhe 2003, ZPZHML/DML i ka zhvarrosur tre trupa të paidentifikuara nga varrezat (këta trupa ende nuk janë identifikuar). Në vitet pasuese DML i ka zhvarrosur gjashtë trupa të tjera me kërkesë të familjeve të tyre por vetëm tek dy prej tyre është bërë konfirmimi i identifikimit. Së fundmi është identifikuar trupi i tretë si viktimë e 2 majit 1999. Si rezultat i këtyre zhvarrimeve të njëpasnjëshme, DML i ka identifikuar 6 trupa dhe 6 persona janë raportuar të zhdukur por nuk ka pasur përputhje të gjakut dhe eshtrave.

Gjithashtu janë vërejtur disa mospërputhje dhe ndryshime në mes të skicës së vizatuar të varrimit nga fshatarët dhe raportet e TNKLJ në lidhje me zhvarrimet e bëra më 1999. Veç kësaj, plani i shtrirjes së varrezës ka pësuar ndryshim të madh në mes të viteve 2004 deri 2010. Fillimisht mbetjet mortore ishin varrosur në 15 vija paralele, me një hapësirë të ngushtë dhe secila vij përmbante në mes të 4 dhe 7 kufomave. Në vitin 2004, familjet filluan t'i ndërtojnë varret (përmendoret) por duke mos marr parasysh planin fillestar të varreve. Kornizat prej betoni dhe përmendoret janë vendosur përafërsisht në vendin e varrimit fillestar. Kështu është bërë e pamundur që me siguri të gjendet ndonjë mbetje mortore.

Me qëllim të identifikimit të 6 mbetjeve mortore të paidentifikuara, DML ka filluar të kontaktoj me familjet prej ngjarjes së Studimes që t'i njoftoj për dhënien e gjakut. Janë zgjedhur familje në bazë të lokacionit të varreve të të vdekurve të afërmeve të tyre. Një numër i konsiderueshëm kanë refuzuar të japin gjak dhe personat të cilët kane pranuar janë përcjellë për KNPZh. Në mënyrë paralele DML gjithashtu ka vendosur që t'i zhvarros varret me qëllim të mbledhjes së mostrave për analiza të ADN-së me qëllim të gjindjen mbetjet mortore të 6 personave që aktualisht janë të zhdukur.

Deri më tani janë dërguar dy mostra dhe zhvarrimet janë në proces.

5.5 ANALIZAT SIPAS NGJARJES: RASTET TJERA

Përveç Pastaselit dhe Studimes, DML është duke punuar edhe në këto ngjarje: Bishtazhin, Rezallë dhe Makermal.. Planifikojmë që së shpejti të fillojmë me analizat e ngjarjes së Dubravës.

5.5.1 Bishtazhini, Komuna e Gjakovës

Një numër i kufomave dhe pjesëve të trupit të paidentifikuara të zhvarrosura nga TNKLJ në varrezën e Gjakovës ende janë të paidentifikuara (kodi i lokacionit CZ). Në vitin 2008, DML ka filluar të kontaktojë me familjet e viktimave të ngjarjes së Bishtazhinit me qëllim të njoftimit të tyre për dhënien e gjakut. Deri më tani të afërmit kanë dhënë mostra gjaku për 16 viktima. Gjashtë mbetje mortore janë zhvarrosur dhe identiteti i pesë prej tyre është konfirmuar dhe identifikimi është në pritje. DML do të vazhdojë të kontaktoj me familjet për mbledhjen e gjakut.

5.5.2 Rezalla, Komuna e Skenderajt

(Shih paragrafin 2 më lart) DML do të dërgoj më shumë mostra shtesë dhe më shumë familje do të kontaktohen për mbledhjen e gjakut.

5.5.3 Makërmali, Komuna e Skenderajt

(Shih paragrafin 2 më lart) Në vitin 2007, ZPZHML/DML ka zhvarrosur mbetjet mortore të varrosura nën emrin (të pa cekur) për të konfirmuar identitetin. Identiteti ishte negativ dhe pastaj DML ka filluar të kontaktoj me familjet prej ngjarjes së Makërmalit që t'i njoftoj për dhënien e gjakut. Meqë varreza është zhvarrosur nga TNKLJ në vitin 2000 (kodi i lokacionit ZF dhe RY) DML ka pasur mostra shtesë dhe gjashtë prej tyre i ka dërguar pa i zhvarrosur mbetjet mortore. Janë konfirmuar tri identifikime, dy janë pritje dhe një ishte negativ por më vonë është identifikuar si një kufomë që ishte varrosur me një emër tjetër.

5.5.4 Zinxhiri i identifikimeve të gabuara

Hulumtimi në identifikimet e gabuara ka zbuluar nivelin e ndërlikimit të panjohur më parë. Në vitin 2010 është zbuluar zinxhiri i identifikimeve të gabuara. Kjo është sqaruar më poshtë (emrat e vërtetë janë harruar:

Kufoma që është besuar të jetë Viktima "A" është varrosur nga Familja "A" në Suharekë më 1999.

Megjithatë ZPZHML ka gjetur dhe identifikuar Viktimën e vërtetë "A" në vitin 2007 në Serbicë të Ulët. Pastaj ZPZHML ka njoftuar familjen dhe kufomat janë shkëmbyer.

Trupi i zhvarrosur është transferuar në morgun e ZPZHML-së ku edhe së fundmi është identifikuar në 2010 si Viktima B nga Pastaseli.

Megjithatë, kufoma që është besuar të jetë Viktima "B" është varrosur nga Familja "B" në Suharekë më 1999.

DML e ka rregulluar këtë shkëmbim të ri të kufomave. Pas zhvarrimit kufomës e cila gabimisht ishte identifikuar si Viktima "B" do t'i bëhet autopsia nga DML dhe mostrat e eshrave do të dërgohen për analiza të ADN-së.

Në pranverë të vitit 1999 që të dy këto kufoma ishin varrosur në varrezat e Suharekës. Ato ishin vetëm pak metra larg njëra tjetrës. Asnjëri prej tyre nuk ishte raportuar si i zhdukur.

Megjithatë, i biri i vërtetë i Viktimës "A" i cili ishte i raportuar si i zhdukur në vitin 2001, përfundimisht është gjetur në varrezat e Tususit në vitin 2004 dhe është identifikuar në vitin 2009. Identifikimi i që të dy viktimave "A" dhe djali i tij ka qenë mundësia e vetme sepse ka pasur mostra të gjakut për përputhje në ADN.

Për këtë është me rëndësi që familjarët të japin mostra të gjakut kur ato i kërkon DML-ja edhe nëse ata nuk kanë ndonjë të afërm të zhdukur.

5.6 PËRFUNDIMI

Identifikimi i gabuar mund të jetë deri në 11% të mbetjeve mortore të varrosura nga familjet në vitin 1999 dhe 2000 pa identifikime shkencore. Pothuajse asnjë prej këtyre viktimave nuk janë raportuar si të zhdukur dhe familjet nuk kanë dhënë gjak. Identifikimet e gabuara nuk ndodhin shpesh për të arsytuar ri-zhvarrosjen sistematike të të gjitha mbetjeve mortore të varrosura në vitin 1999, proces i cili ka mundur të shkaktoj trauma dhe dhimbje të panevojshme të familjet përkatëse. Në anën tjetër numri i tyre nuk është i parëndësishëm dhe mbetjet mortore të varrosura gabimisht mund t'i takojnë ndonjë personi i cili është raportuar si i zhdukur përderisa kthimi të trupi përkatës mund të mbetet në mes të mbetjeve mortore të tanishme të pidentifikuara në morgun e DML-së. Secili rast i mundshëm me identifikim gabuar meriton një qasje dhe strategji individuale.

Në shumicën e rasteve hapi i parë qëndron në mbledhjen e mostrave të gjakut dhe informatave para vdekjes dhe gjithashtu janë dërguar për analiza të AND-së mostrat shtesë të disponueshme. Zhvarrimi bëhet vetëm kur është e nevojshme ose edhe kur kërkohet nga anëtarët e familjes.

KAPITULLI 6- ESHTRAT E RIBASHKUAR GABIMISHT

Rasti i shqyrtuar i kryer nga EULEX-i ka treguar se në disa raste disa eshtra janë ribashkuar gabimisht të disa trupa të tjerë. Kjo ka ndodhur veçanërisht me rastet në varreza masive ku ka pasur shumë trupa të përzier dhe pjesë të trupit. Rasti i cili është dëmtuar më së shumti është rasti i varrezës masive në Liqenin e Peruçacit (Banja Basta) në Serbi. Kjo çështje është përshkruar më poshtë:

6.1 RASTI I LIQENIT TË PERUÇACIT:

Posa është lokalizuar varreza masive, trupat dhe pjesët e trupit janë zhvarrosur dhe është kryer autopsia nga autoritetet e Serbisë. Pasi që është kryer autopsia dhe është bërë identifikimi, mbetjet mortore janë transferuar në Kosovë në data të ndryshme. Në Kosovë, ekspertët ndërkombëtarë të ZPZHML-së e kanë paraparë se është e nevojshme një punë shtesë mjeko-ligjore. Është bërë inspektimi mjeko-ligjor. Në këto inspektime është zbuluar se janë bërë gabime në autopsinë fillestare kryesisht në përcaktimin e shkaktarit të vdekjes dhe përcaktimin e numrit të viktimave prezentë. Tabela më poshtë tregon dallimin e numrit të viktimave:

Tabela 8:Rasti i Liqenit të Peruçacit – Transferimi prej Serbisë në Kosovë

Transferimi #	Data	Numri i viktimave të deklaruara dhe të dorëzuara nga Serbia	Numri i vërtetë i caktuar nga ZPZHML
1	16 dhjetor 2004	12	15
2	07 shtator 2005	8	10
3	25 nëntor 2005	3	5
4	30 qershor 2006	18	20

Autoritetet serbe gjithashtu kanë dorëzuar disa thasë trupa me eshtra të përzier prej disa personave të paidentifikuar. Megjithatë, teknologjia e disponueshme e ADN-së në KNPZH e ka kufizuar në atë kohë llojin e mostrave që kanë mundur të dërgohen për paraqitjen e gjendjes.

Kur EULEX-i ka filluar punën në DML në dhjetor të 2008 i ka zgjedhur shume lloje të eshtrave për teknikën për demineralizim. Duke e parë se është një numër i madh i personave të zhdukur nga ngjarja që lidhet me varrezën masive është bërë e nevojshme që të merren mostrat e një numri të madh të eshtrave (200 mostra në vitin 2009 dhe 200 në 2010).

Në 400 mostrat e dërguara për analiza janë identifikuar vetëm 4 trupa. Mbi 320 mostra kanë rezultuar në ribashkimin e individëve që tanimë janë identifikuar kurse 50 mostra kanë dështuar. Rreth 26 mostra janë në pritje të rezultatit.

Hulumtimet e EULEX-it kanë treguar se autoritetet serbe i kanë ribashkuar eshtrat pa analiza të ADN-së. Këta trupa janë dorëzuar në Kosovë dhe prej atëherë nuk ka pasur mundësi të zbulohet problemi, trupat i janë dorëzuar familjeve me disa eshtra që nuk i kanë takuar atyre. Deri më sot EULEX-i ka identifikuar 15 raste të tilla.

6.2 ÇFARË DUHET TË BËHET

Eshtrat të cilët gabimisht janë ribashkuar duhet të kthehen dhe të bëhet testi i ADN-së. EULEX-i beson se përderisa shihet se shumica e eshtrave do të rezultojnë me ribashkim, ne shpresojmë se do të bëhen identifikime të reja.

Varret do të hapen. Eshtrat që janë bashkuar gabimisht do të merren nga mbetjet mortore në varr (dmth se nuk do të ketë zhvarrime). Do të merren mostra të reja të ADN-së për analiza nga krahu, këmba dhe eshtrat e kokës.

Ndonjë ribashkim do të bëhet dhe ndonjë identifikim i ri do të përpunohet si normal (Shih Kapitullin 10: Plani punues për vitin 2011).

KAPITULLI 7- HETIMET ARKIVORE

ZPZHML-ja ka arritur progres të konsiderueshëm në analizimin e 85,000 faqeve të raporteve të Tribunalit të Hagës. Këto dokumente përfshijnë raporte mbi hetimet e vendngjarjeve të vdekjeve, zhvarrimeve dhe autopsive të viktimave të identifikuar dhe të paidentifikuar të kryera nga Tribunali në vitin 1999 dhe 2000. Ato nuk japin informata në vazhdimësi mbi lokacionet se ku për herë të fundit trupat e viktimave janë varrosur apo kujt i janë dorëzuar ato, por ato japin shtigje të reja mbi hetimet në të cilat EULEX/DML është duke bërë përpjekje që të lokalizoj varrezat. Ky lloj i të dhënave është i kombinuar me burime tjera të të dhënave gjysmake që mundësisht të ndërtohet një informatë e plotë. Gjatë vitit 2010, më shumë raste të TPNJ-së janë paraqitur si të padobishme; ato si më potenciale janë prioritetizuar për veprime të mëtutjeshme, të cilat në disa raste kanë përfshirë vlerësime të vendndodhjes dhe zhvarrime. Zhvarrimet e kryera në Novolan, Obrançë dhe Matiqan (gjithsej 9 trupa dhe 3 pjesë të trupit ishin përmirësuar) kanë rezultuar nga dokumentet e analizave të TPNJ-së dhe ZPZHML-së, së bashku me disa vlerësime të terrenit. Kjo punë do të vazhdojë edhe në vitin 2011.

Gjithashtu, të dhënat e TPNJ-së janë të rëndësishme në lehtësimin e drejtimit të hetimeve në identifikimin e gabuar të mundshëm prej vitit 1999 dhe 2000.

KAPITULLI 8- DORËZIMI I MBETJEVE MORTORE TEK FAMILJET

Pasi të bëhet identifikimi dhe certifikimi nga DML, pjesëtarët përkatës të familjes informohen personalisht. Në rastet kur vetëm pjesët trupore identifikohen, DML këshillon familjen që të vonojnë dorëzimin dhe datën

e varrimit derisa të gjitha pjesët trupore të identifikohen ose deri sa rasti të jetë mbyllur. Kjo parandalon pikëllimin dhe harxhimet e panevojshme për familjet. Sidoqoftë, zgjidhja përfundimtare i takon gjithmonë të afërmeve. Disa familje vendosin që t'i varrosin eshtrat sapo të është kryer identifikimi. Në disa raste identifikohen eshtra shtesë pas varrimit dhe DML kërkon që të hapet varri me qëllim të ribashkimit të eshtrave, nëse familja këtë e dëshiron.

Në vitin 2010, DML iu ka dorëzuar familjeve 103 mbetje mortore.

KAPITULLI 9- SHOQËRIA CIVILE

Pjesëmarrja e shoqërisë civile, posaçërisht e Shoqatave të Familjeve, në procesin e kërkimit të të zhdukurve është e një rëndësie jetike për të arritur rezultate. Gjatë gjithë vitit 2010, DML është kujdesur për shkëmbimin e informatave me Shoqatat e Familjeve nëpër gjithë Kosovën dhe më gjerë. Ne kemi kuptuar se shoqëria civile ka informata të veçanta me të cilat na ka drejtuar në rrugë të reja për vende tjera të supozuara për varreza dhe hollësi të veçanta me të cilat hetimet tona kanë përparuar.

EULEX/DML është takuar me familjet, Shoqatën e Familjeve dhe partnerë të tjerë në më shumë se 70 raste në vitin 2010.

Është me rëndësi të vazhdohet kjo shkallë e bashkëpunimit me të gjitha shoqatat e familjeve edhe në vitin 2011. EULEX/DML do të jetë proaktiv në lidhje me këtë dhe shpresohet që familjet të bashkëpunojnë me ne gjithashtu. Kjo është me rëndësi të veçantë për të arritur përparim si më poshtë:

1. Lokacionet e varrezave potenciale,
2. Koordinimi me pjesëtarët të cilët nuk janë anëtarë e të cilët duhet të dhurojnë mostra të gjakut për analizë të AND-së,
3. Bindja e familjeve për të dhuruar gjak për analizë të AND-së,
4. Mbledhja e informatave për rastet specifike,
5. Shkëmbimi i informatave dhe koordinimi i përgjithshëm,
6. Mbështetja e studimit sistematik për varreza dhe projekteve të ngjashme.

Sfidat më të mëdha për vitin 2011 janë gjetja e informata mbështetëse për lokacionin e varrezës potenciale, përcaktimin e identifikimit të mbetjeve mortore të mbajtura në DML dhe zhvillimin e bashkëpunimit me familjet dhe Shoqatat e Familjeve.

Ne i inkurajojmë të gjithë ata që mund të kenë informata të paraqiten tek ne. Të gjitha informatat e pranuar do të trajtohen me konfidencialitetin më të madh. EULEX/DML do të përgjigjet me kohë ndaj të gjitha informatave të pranuar.

KAPITULLI 10- PLANI I PUNËS PËR VITIN 2011

EULEX-i përpiket që të transferoj plotësisht Operacionet lidhur me Personat e Zhdukur tek Ministria e Drejtësisë (MD) pasi që EULEX-i të jetë i kënaqur se punët komplekse mund të kryhen në mënyrë shkencore, të paanshme dhe profesionale. Tanimë Ministria e Drejtësisë menaxhon një numër të madh të punës. Të gjitha informatat jo të ndjeshme të nxjerra nga EULEX-i shkëmbehen me drejtorët vendor dhe punonjësit përkatës. Sidoqoftë, ende nuk ka kapacitet vendor që merret me punët hetimore, zhvarrimet dhe mjekësinë ligjore antropologjike. Në vitin 2011, EULEX-i do të vazhdojë që të inkurajoj MD që të zhvilloj kapacitet vendor të nevojshëm me qëllim të menaxhimit me përgjegjësi të Operacioneve lidhur me Personat e Zhdukur.

Në vitin 2011 EULEX-i dhe DML do të vazhdojnë të punojnë së bashku në zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Plani i punës do të shtrihet në punën e filluar në vitin 2010. Prioritetet janë si në vijim:

- Fushata e synuar për zhvarrosje. Sfidë kryesore për lokalizimin e mbetjeve mortore të të zhdukurve mbetet mungesa e informatave të besueshme. Rreth 18 vende janë shënuar për vlerësim në vitin 2011. Kjo përfshinë edhe punën në disa varreza të mëdha dhe kërkimin për së paku dy varrezat masive në Kosovë.
- EULEX-i do të vazhdojë të kryej veprime me qëllim të lokalizimit dhe gjetjes të vendeve të varrezave të supozuara përtej kufijve të Kosovës.
- Implementimi i projektit fotografik satelitor për kërkimin e llojeve të veçanta të varreve në bashkëpunim të ngushtë me njësitet e EULEX-it.
- Do të përfundohet ribashkimi dhe identifikimi i punës në lidhje me rastet e Batajnicës dhe Bajna Bastës.
- Në koordinim me organizata relevante do të mblidhen sa më shumë mostra të gjakut dhe eshtrave me qëllim të kompletimit të pjesëshëm të mostrave të gjakut.
- Në koordinim me shoqatat e familjeve dhe organizatat e familjeve, do të hartohet një rregullore për varrimin e pjesëve të identifikuara të trupit, mbetjeve mortore të paidentifikuara (eshtrave të djegur ose të thyer, etj.) dhe mbetjeve mortore të identifikuara të refuzuara nga familjet.
- Vazhdimi i përpjekjeve për identifikimin e mbetjeve mortore dhe rastet e mbyllura të ruajtura në DML.
- Rastet e mbyllura që kanë arritur limitin e analizave mjeko-ligjore (rastet e djegura – rastet e mbyllura të personave të zhdukur në bazë të rrethanave të dëshmive kurdo që është e mundur).
- Përfundimi i marrjes së mostrave të eshtrave nga të gjitha rastet.
- Adresimi i çështjes së ribashkimit ose ribashkimi pas dorëzimit në përgjithësi.
- Do të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë MD në implementimin e një trajnimi të fokusuar dhe intensiv për: 2 trajnues vendor të mjekësisë ligjore për zhvarrime dhe autopsi. Është shumë thelbësore që MD të bashkëpunojë me EULEX-in në zhvillimin e qëndrueshmërisë vendore.